



Sejdi Bitiçi, në mes së bashku me Naum Priftin (djathtas) dhe Gjekë Marinajn



Editori i "Diellit" Anton Çefa dhe Gjekë Marinaj



Pjesëmarrësit duke ndjekur aktivitetin

# Një ditë mes njerëzve të penës në New York... He tjetër, takohemi në Dall



## Nga Dalip Greca

### MANHATTAN

Sejdi Bitiçi sërish e vuri restorantin e tij në shërbim të bashkatdhetarëve. Këtë herë, restoranti i tij "Macelleria" në Manhattan ku gërshetohet tradita shqiptare me atë amerikane dhe italiane, u vu në shërbim të artistëve, poetëve dhe shkrimtarëve mërgimtarë. Nuk është e para herë që ai tregon respektin dhe bujarinë e tij karakteristike ndaj njerëzve të artit. Shpesh tek ai kanë bujtur gazetarë e poetë, njerëz që Sejdi Bitiçi i respekton në mënyrë të veçantë. Mes tyre e ndjej veten të gëzuar, thotë ai për Illyria-n. Ai ka krijuar një ambient romantik, enkas për artistët; një ambient gjysëm të ndriçuar, vend magjik për krijuesit.

Sa shumë poetë dhe shkrimtarë qenkan shkukur nga hapësira shqiptare? Nga Shqipëria dhe Kosova, nga Lugina e Preshevës, Maqedonia dhe Mali i Zi... Kanë lënë atdheun dhe zemra u pikon mall përmes poezive dhe krijimeve që i paraqiten plot dinjitet në takimin e parë të realizuar në Amerikë. Ata kishin ardhur nga larg, kishin udhëtuar nga Bostoni, Nevada, Washingtoni, Texas, New Jersey, New York-u, secili kishte udhëtuar me shpenzimet e veta, edhe hotelet i paskan përballuar vetë; kishin lënë hallet e përditshme për të qenë së bashku në një ditë të veçantë, në ditën e takimit të shkrimtarëve të diasporës. I shoh ashtu të mbledhur grupe-grupe tek bisedojnë me zë të lartë:

- Po ti kur paske ardhur, or Ramiz?

- Viktor, sa kohë ke në Amerikë?  
- Edhe ti këtu, Klajd?...  
- Çfarë je duke shkruar, Albana?...  
- Rozi, urime për librin e ri!  
- Ej, Petraq, ç' thotë Virxhinia?

Ndërsa dëgjoj copëza dialogjesh, sodis nga larg Ramiz Gjini, prozatorin brilant, i cili duket se dylufton me vetminë brerëse të emigrantit, edhe pse vetmia nuk ia ka zbehur dëshirën për të shkruar. Tregimi i tij, "Gjurmë xhindi mbi dëborë", i botuar në revistën "Pena" është një ndërthurje fantastike e imagjinatës me rrëfimin dhe përshkohet nga një linjë lirike që të zbut shpirtin.

Ndërsa Lugj Çekaj, sekretari i shoqatës, i suksesshëm me librin poetik "Vjeshta në aeroporte" dhe së shpejti do të dalë me librin e ri në prozë, nuk ndjehet. Ka zënë një cep të tavolinës që përshkon tej përtej sallën dhe të duket si një statujë e heshtur... Adnan Mehmeti, poeti nga Bujanoci, e sheh veten të rrethuar nga kolegët prej Shqipërie dhe shkëmben librat e tij me poezi; të njëjtën gjë bën edhe Viktor Martini, tek lëshon autograf mbi librin e tij që ka sjellë nga Bostoni, "Dëshmoj (unë, hija dhe vuajtja), Tom Mriaj dhe Klajd Kapinova dhurojnë librin e tyre "Lidhja e Prizrenit", Qazim Krushaj, pasi falë me autograf librin e tij, "Atdheu i poetit, Shqipëria", deklaron poezinë e tij më të re kushtuar shoqatës, Mëhill Velaj, recitoi poezi nga libri i tij për fëmijë... Petraq Pali, autor i librit "Jam larg" - Poema e emigrantit, kalon nëpër tavolina dhe njihet me të porsaardhurit.

Shkrimtarët përruan aty edhe numrin e parë të revistës së tyre të re, "Pena". Shumë fjalë përgëzuese për

Gjekë Marinajn, poetin dhe publicistin, i cili gjithçka e përballoi vetëm. Ai e ndjen veten në pozicion të vështirë tek e lëvdojnë të gjithë dhe ka gjetur një fjali për t'u kthyer përgëzimet: "Gjithçka e ka bërë shoqata, jo unë!"

### Në gjurmët e rilindasve...

Edhe pse organizatorët përpiqen t'i shmangin format zyrtarë të një takimi formal, protokollit, gjithsesi u respektova. Kryetari i Shoqatës, shkrimtari Naum Prifti, mbajti një fjalim të shkurtër, duke u uruar mirëseardhjen anëtarëve të shoqatës dhe të ftuarve.

Sot, tha ai, në këtë ditë të shënuar kur shoqata shënon takimin e saj të parë, kam kënaqësinë t'ju uroj mirëseardhjen në qytetin e madh të Amerikës dhe të botës, në New York.

Prifti deklaroi se shoqata shënon një etapë të re për komunitetin shqiptar në Amerikë. Për herë të parë krijohet një shoqatë shkrimtarësh shqiptarë - amerikanë me qëllim që të aktivizojë kontigjentin e artistëve që mes vështirësive të ndryshme përballojnë jetën në atdheun e adaptuar, ndërsa në shpirtin e tyre vazhdon të vezullojë flaka e krijimit.

"Të dashur miq! Historikisht diaspora ka luajtur rolin e saj të madh në kulturën dhe letërsinë shqiptare. Një sërë kryeveprash letrare u krijuan jashtë kufijve administrativë në kohë të ndryshme, nga De Rada, Naimi, Çajupi, Fan Noli, Konica, Pipa, etj. Ne po e përtërijmë këtë traditë duke i krijuar mundësi botimi secilit në mënyrë që të shpalesë vlerat e veta, pa mbetur në pusin e harrësës dhe të humbjes së

identitetit.

Suksesi më i madh i shoqatës është botimi i revistës "Pena", me krijimet e anëtarëve të shoqatës dhe të bashkëpunëtorëve. Për herë të parë del në Amerikë një revistë letrare e këtij niveli dhe e kësaj madhësie. Me këtë rast më lejoni të falënderoj në emrin tuaj zotin Gjekë Marinaj, i cili mblodhi materialet, i redaktoi, i faqosi dhe e shtypi revistën me shpenzimet e tij.

Ne duhet të jemi krenarë për shoqatën pa rënë në vetëmburrje, të jemi modestë pa qenë euforikë, të falënderojmë ata që na kritikojnë, dashamirësit dhe t'u përgjigjemi me dinjitet atyre që na etikojnë me cilësime politike që nuk na përkasin", tha kryetari i shoqatës.

Askush s'mund thyejë moralin tonë të lartë, vetëbesimin që kemi nisur një aktivitet të vyer, tha më pas Prifti. Gjatë 14 muajve shoqata ka kryer veprimtari të dobishme kulturore duke qenë e ndërgjegjshme se çdo fillim është i vështirë.

Shoqata jonë nuk synon fitime materiale, por na duhet me domosdo të fitojmë diçka tjetër më të vështirë, dinjitetin, respektin dhe nderimet e komunitetit këtu dhe në mbarë kombin shqiptar.

Kjo arrihet vetëm me mund që kërkon përkushtim, energji, zotësi dhe mjete. Krijimtaria artistike si fusha jonë kryesore nuk duhet të mbetet e vetme. Na bie barra të mbushim boshllëkun që ka letërsia shqipe për pasqyrimin e jetës së mërgimtarëve, të vlerësojmë qoftë edhe në retrospektivë botimet jashtë atdheut në kohën e diktaturës, si të vetmet botime që mbartin mendimin e lirë,

të paçensuruar, të evidentojmë figurat e kulturës, të artit dhe të shkencës, të vdekur dhe të gjallë, të hetojmë dhe të nxitim çdo veprimtari që i shërben ruajtjes së traditave dhe të identitetit tonë kombëtar.

### Krijimtaria e mërgimtarëve; frymëmarrje Shqipërie, ndjenjë malli e krenarie ...

Takimit nuk i munguan as përshëndetjet, madje ato erdhën të kombinuara nga Amerika dhe nga Evropa. Peter Prifti, studiues, publicist, shkrimtar, kishte sjellë një përshëndetje emocionuese për shkrimtarët dhe poetët mërgimtarë. Shoqata e re e shkrimtarëve shqiptarë në Amerikë, ka hyrë në rrugën e lashtë e të nderuar të shkrimtarëve patriotë, theksonte në përshëndetjen e tij, profesor Peter Prifti. Ajo ecën në gjurmët e ndritura të shoqatave të rilindasve si: "Shoqëria e Stambollit", që u themelua që në vitin 1879; Shoqëritë "Drita" dhe "Dituria" të Bukureshtit, shoqëria "Dëshira" e Sofjes, dhe shoqëria "Bashkimi" që u krijua në Shkodër në fund të shekullit të 19 - të. Është e tepër të flas për punët e lavdishme të këtyre shoqatave, sepse ato dihen nga të gjithë. Vlen të përmend se shoqata juaj e re, ka një paraardhës edhe këtu në Amerikë. Kjo është Shoqata e Studentëve Shqiptarë të Amerikës, që u themelua në Boston më 1920, me qendër në Harvard University. Ajo organizonte leksione, shfaqte drama dhe informonte publikun mbi historinë dhe traditat e Shqipërisë.

Shoqata juaj po bën hapat e para të foshnjërisë. Për themelimin e saj një meritë e veçantë i takon djaloshtit poet dhe publicist, Gjekë Marinaj, i cili nji-





Petraq Jani, i pari djathtas, me dy miqtë e tij...



Nga e majta publicisti Ildriz Lamaj, piktori Astrit Tota dhe publicisti Andon Dede



Gazetarja dhe poetja Albana Mëlyshi së bashku me Xhevat Limanin (majtas) dhe Ramiz Gjinin



Viktor Martini duke përcjellë mesazh tolerance



kujtimit gjatë takimit

het si inisiatori i saj. Rruga që ka përpara shoqata është e panjohur. Por duke gjykuar nga kompetencat e drejtuesve të shoqatës, mendoj se ajo premtion punë të mira, në dobi të letërsisë dhe kulturës shqiptare.

Me duartrokite u prit përshëndetja e poetit Agim Shehu, i cili jeton në Zvicër. Ja teksti i përshëndetjes:

“Nga miku im, piktori Astrit Tota mësova për një tubimin tuaj – krijuesish shqiptarë – në New York.

Pak rëndësi ka nëse s’joh pjesëmarrësit apo imtësitë, mjafton që aty ndër “nikoqirët” kryesorë është kolegu dhe miku im i herët, Naumi, njeriu tek i cili me kohë kanë qënë të harmonizuara në mënyrën më fisnike artistike, demokrati dhe shqiptari.

I emocionuar dhe i malluar ndodhem pranë jush, me një zë modest poeti shqiptar, të cilit largësia nuk ia zvogëlon përmasat e intimitetit. Kjo është në natyrën e shkrimtarëve shqiptarë që tek hapësirat e mërgimit ku i hodhi fati a mbijetesa, ngarkonin hapësirën e kombit të tyre, në përmasat etniko – historike dhuruar nga natyra dhe historia. Këtë të vërtetë e mban gjallë veçanërisht ndjeshmëria prej artisti e krijuesve atdhetarë, për të cilët demokracia pa kombin është lule në kostumin e të vdekurit. Kohët kanë treguar se arti i një populli është tregues vitaliteti i tij dhe dëshmi se ai popull meriton të jetojë i trashëguar. Qoftë dhe një krijimi ynë i vogël por i çiltër e i bukur, është një frymëmarrje Shqipërie veçanërisht në hallet e saj, që i dërgohet nga larg.

Afria e artistëve me njëri – tjetrin

është bashkëjetesa e vlerave më fisnike të një populli dhe shembëlltyra më e besueshme e bashkimit të tij, kur udhëhiqen nga kombi dhe demokracia. Kjo merr vlerën dhe rrezatimin më të gjerë, veçanërisht kur zhvillohen te miku më i sinqertë e më i madh historikisht i shqiptarëve, Shtetet e Bashkuara”.

Shkrimtarja Albana Mëlyshi u solli të pranishmëve përshëndetjet e profesor Sami Repishtit.

Shkrimtarja Rozi Theohari paraqiti aktivitetin e shoqatës, duke u ndalur në veprimtarinë 14 mujore të saj. Ajo foli për integrimin e shoqatës, për lidhjet e saj me shoqatat e shkrimtarëve në Tiranë e Prishtinë.

Redaktori i gazetës “Dielli”, poeti dhe publicisti, Anton Çefa, përcolli me shqetësim intelektual këndvështrimin e tij për të ardhmen e shoqatës. Ai kërkoi më shumë frymëmarrje, më shumë integrim dhe lidhje të ndërsjelltë me krijuesit e tjerë mërgimtarë në Evropë e Kanada. Çefa solli si shembull lidhjet që mban “Dielli” me shqiptarët e Rumanisë, veçanërisht me at e bir, Kopi e Ardia Kuçuku, që po i japin emër letrave shqipe në Rumani.

Revista e tyre me përmasat e një libri është një përvojë që mund të na shërbejë, tha ai. Genc Leka solli një fragment në prozë poetike të krijuar nga ai për lashtësinë e flamurit shqiptar. Dramaturgu, regjisori e aktori i njohur, Xhevat Limani, krijoi një ambient dridhëruar tek ‘recitoi fragmente të poemës “Bagëti e Bujqësi” të poetit tonë kombëtar, Naim Frashëri.

(Vijon në Faqen 24)

## Urim për ditëlindje



Prindërit, Fanoli dhe Diana Cami, vëllau Ferdinadi, motra Rajmonda dhe vëllau i vogël Osmani, i urojnë ditëlindjen vajzës përkatësisht motrës së tyre, Shkëlqesës, e cila më 17 shkurt 2003 mbush 17 vjet.

**Shëndet e suksese. Kremtofish shumë e shumë ditëlindje si kjo.**




## Një ditë mes njerëzve të penës në New York...Herën tjetër, takohemi në Dallas!

(VLON NGA FAQJA 19)

### Të djeshmit dhe të sotmit - së bashku në shërbim të Shqipërisë

Kuvendi i shkrimtarëve dhe poetëve mërgimtarë u përshkua nga toleranca dhe respekti për njëri-tjetrin. Kishte mes tyre edhe nga ata që jo vetëm e patën mollë të ndalueme krijimtarinë për gjysëm shekulli izolim, por e paguan atë me dhjetëra vjet burg e tortura. Pikërisht në emër të tyre e mori fjalën Viktor Martini, i cili kishte sjellë me vete dhe librin e tij: "Dëshmoj" (Unë, hija dhe vuajtja). Libri i tij është më shumë se sa aktakuzë për regjimin, edhe pse mllëfi nuk është mesazhi i librit. I tillë ishte dhe diskutimi i tij që nuk u karakterizua nga mllëfi për vuajtjet e burgut, por më shumë ishte një këmbanë kujtese dhe ndjesi betimi për t'i shërbyer Shqipërisë.

Ishte e parathënë që ai ta niste diskutimin e vet me kujtesën: Kur nëpër burje, kampe e internime, torturoheshin intelektualët opozitarë të diktaturës, kur pranvera e një pjese të rinjëve shqiptarë dergjej në ferrin e diktaturës e bashkë me talentet e tyre letrare varroseshin në varreza pa emër, lakejtë e diktaturës paraqitnin diktatorët të denjë për të qeverisur popullin shqiptar dhe Shqipërinë. Shërbëtorët e paraqesnin vendin e izoluar, kopsht të lulëzuar. Kështu e kërkoni parimet e dogmës së realizmit socialist, ku realiteti duhej lustruar, po kurrë s' duhej nxirë, ndryshe do të përfundonte në ferr. At Gjergj Fishta, P.Mëshkalla, Faik Konica, shpallëshin armiq dhe të padenjë, ndërsa e veprat e tyre ndaloheshin rreptësisht që të qarkullonin. Krijuesit e metodës socialiste



Pjesmarrësit ndjekin takimin



Roza Theohari, duke paraqitur aktivitetin 1-vjeçar

rrekeshin të krijonin sipas shijes së ustait, ndryshe përfundonin në qeli. Është e vlefshme thënia e sociologut amerikan, Rolph W. Emeson: "S'ka gjë më të neveritshme e të turpshme kur skllavi i thur lavdi skllavërisë duke e ujitur atë..."

Por publicisti, shkrimtari, që kaloi jetën burgjeve është tolerant. Iku e djeshmja, ndoshta brenda kësaj sale jemi të përzier, të sotmit dhe të djeshmit, tha ai. Nuk i njoh të gjithë ata që janë në këtë sallë, si do që të jemi, i përkasim një gjaku e një gjuhe, jemi bijtë e Nënës Shqipëri. Janë të gjitha mundësitë për t'i korrigjuar gabimet politike-letrare, ashtu siç korrigon studenti hartimin në shkollë. Le të premtojmë si vëllezër, pa shtyrë njëri-tjetrin me bërryla, se do t'i japim Atdheut atë çka i mungoi për 50 vjet duke lënë prapa një shekull. Me penat tona të lartësuar dinjitetin e kombit. Vetëm kësh-

tu, brezat që do të vijnë pas do të na jenë mirënjohës dhe ne do të jemi krenarë se kemi shkruar me gjuhën e bukur shqipe, që është gjuhë Perëndie (Sidomos në mërgim ajo tingëllon si gjuhë e shenjtë me të cilën kanë folë perënditë... vetëm ajo ta zbut shpirtin e gërryer nga malli)...Viktori u duartrokit gjatë sepe foli me zemër...

Ata zbritën si yje poetik në rrokaqiejtë e New York-ut

Takimi përfundoi me një fotografi të përbashkët përpara restorantit Macelleria. Së bashku me krijuesit, edhe pronari Bitiçi. Shkëpus për pak çaste themeluesin e Shoqatës njëkohësisht drejtor i saj pranë Zyrës Amerikane N.P.O. në Washington DC, shkrimtari Gjekë Marinaj. Me ç'mbresa largohet nga takimi inisiatori i krijimit të shoqatës?

Përgjigja ka brenda vetes

kënaqësinë e një takimi të ngrohtë: "Kur mbresat ngarkohen me eksperiencën e momenteve të tilla, qenka e mundur që ato, plot zhurmë të brendshme, të fitojnë atdheun e tyre të përhershëm brenda njeriut. Koha ka vërtetuar se e kaluara në mënyrë konstante ndikon mbi të ardhmen. Pikërisht këtu qëndron edhe e papritura ime për takimin e poetëve dhe shkrimtarëve të diasporës. Po largohem me bindjen e plotë se e sotmja jonë do të influencojë për mirë tek e ardhmja. Pse ta fsheh, ky takim shtampi fletët e momenteve më të lumtura të jetës time si poet".

Gjeka thotë se ndonëse takime të tilla janë të mundimshme dhe kërkohen shpenzime të mëdha, sakrificat e bëra nga shkrimtarët dhe poetët, të cilët jetojnë në disa nga pikat më të skajshme të Amerikës, nuk shkuan kot. Ata u shkëputën nga qielli i gjerë amerikan, për të zbritur si yje poetik

në rrokaqiejtë e kryeqendrës amerikane, duke e zbuluar qytetin e New York-ut me praninë e tyre. Por edhe New York-u, në ringjiten drejt lartësive që ata u përkasim, u mbështolli në gjoks diçka tepër të bukur, diçka të papërsëritshme, diçka që pas 9 shkurtit 2003, s'mund të blihet më as me para as me mundime: u dha bekimin që emri i tyre të hyjë dhe të mbetet në historinë e takimit të parë të Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë.

Kur e pyes Gjekën për revistën "Pena", si u prit krijesa e parë nga ata që fërshfërijnë në fletët e saj, ai thotë se si krijesë e përbashkët, si krijesë e parë, ajo mbetet e shenjtë. Anëtarët e Shoqatës e deshën revistën e tyre "Pena".

Ata e mbajtën nëpër duar me dashurinë dhe kujdesin që tregon një nënë me fëmijën e porsalindur të saj. Në duart e tyre "Pena" më ngjau më madhështore, por, në të njëjtën kohë, më humane. Edhe në qoftë se gjatë udhëtimit nëpër përrënjtë e kohës diçka ka avulluar, diçka është shkëputur pa përsosmërinë e dëshiruar, ata e njohën menjëherë punën e tyre shpirtërore, e cila, më së fundi, arriti të derdhet në fletët e bardha të revistës së tyre.

Për takimin e ardhshëm, ende nuk është marrë vendimi final, por Gjekë Marinaj shpreston se i takon Dallasit që t'i mbledhë tjetër herë.

Vështirësitë shpesh i mundin dëshirat në dyluftimin e tyre. Kështu, fatkeqësisht, na duhet ta zgjasim segmentin kohor të takimit nga dy-tre herë në vit, siç do të dëshironim, në një herë në vit. Takimi tjetër do të bëhet në mars të vitit 2004, në Qytetin e Dallas-it, ngaqë ky qytet është edhe pika qendrore e Shoqatës, shprehet ai për Illyria-n.

# Spektakël për festën "Valentine's Day" në Debal Gardens

Të premten dhe të shtunën, 14 dhe 15 shkurt 2003.

Ju argëton Grupi Muzikor "Kastrioti" me këngëtarët:

**Sinan Villasaliu, Eli Fara, Gëzim Nika dhe Aurela Gaçe.**



Nata e parë: \$ 65 (përfshirë darka dhe pijet).

Nata e dytë (e shtunë) \$ 50.

Mbrëmja do të inçizohet me kamerë. Secila familje do të ketë një audiokasetë për kujtim.

Mbrëmja fillon në orën 8 të mbrëmjes dhe zgjat deri në orët e vona të mbrëmjes.

**Debal Gardens**  
8708 18 Avenue  
Brooklyn, NY

**Tel. (718) 331 - 2800**

